



Politikat Kulturore

RAPORT I HULUMTIMIT *dhe Ndarja*

Buxhetore për

Kulturën në Kosovë

Tetor 2014, Prishtinë



Rrjet i organizatave të pavarura
të kulturës të Kosovës
www.forumikulturor.net

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian dhe Olof Palme International Center”

Politikat Kulturore

RAPORT I HULUMTIMIT

dhe Ndarja Buxhetore për Kulturën në Kosovë

Autor: Dren Pozhegu



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Përmbajtja

Hyrje 6

Metodologjia 7

Kufizimet e hulumtimit 8

Konteksti i përgjithshëm 10

Orientimi Strategjik Kulturor 13

Buxheti Qendror për Kulturën 18

Buxheti Lokal për Kulturën 26

Buxheti për kulturën në rajon dhe Evropë 34

Buxheti për institucione publike, insentivat,
dhe institucionet e pavarura 37

Kriteret për ndarjen e buxhetit 42

Konkluzion 46

Hyrje

Në vitet e fundit të historisë së Kosovës, kultura ka zënë një pjesë të neglizhueshme të sferës publike dhe të aktiviteteve publike.

Ndoshta ky fenomen nuk është edhe për t'u çuditur kur kemi parasysh problemet qenësore që kishte popullsia e Kosovës nën regjimin diskriminues dhe shtypës të viteve 1990, vitet e administrimit ndërkombëtar 1999-2008 dhe prioriteteteve shtet-ndërtuese të qeverive të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008. Gjatë kësaj periudhe kohore bashkë me situatën politike, edhe ekonomia e Kosovës degradoi dhe edhe ai zhvillim modest industrial i viteve 1970-1980 u ndal dhe u kthye mbrapsht.

Mirëpo, të gjitha këto ngjarje tani i takojnë historisë. Tani kultura do të duhej të hipte më lartë në agjendat shtetërore të vendit. Zhvillimi i kulturës do të duhej të mos kufizohej me rrethanat ekonomike dhe politike të vendit. Përkundrazi, kultura do të duhej të shihej si një komponentë kyçe për zhvillimin socio-ekonomik – zhvillim ky i cili tashmë është kthyer në prioritetin kryesor të elitës Kosovare. Mendësia që kultura është një gjë e mirë për kohën e lirë dhe është një mjet i mirë argëtimi, por e cila është barrë për buxhetin shtetëror dhe

ekonominë vendore, duhet të tejkalohet. Përkundrazi, kultura duhet të shihet si faktor kyç për zhvillimin socio-ekonomik të vendit, bashkë me faktorët tjerë si zhvillimi i ekonomisë, ambienti dhe sfera sociale.

Fakti që kultura për një periudhë të gjatë ka nxënë një vend të neglizhueshëm në diskursin shoqëror gjithashtu ka rezultuar në prodhim shumë të vogël të njohurive dhe hulumtimeve rreth politikave kulturore të Qeverisë së Kosovës, apo entiteteve të tjera publike. Shumë pak raporte, apo studime janë shkruar rreth fushës së kulturës në Kosovë, edhe pse pas luftës shumë raporte ishin shkruar në fusha të tjera si rrjedhojë e një fluksi të madh të financimit nga institucione dhe organizata ndërkombëtare për sektorin qeveritar dhe joqeveritar. Rrjedhimisht, pak nga politikat kulturore publike të Kosovës janë analizuar deri me tani.

Ky raport ka për qëllim zvogëlimin e boshllëkut të njohurive dhe hulumtimit rreth politikave kulturore të Kosovës, me theks të veçantë në buxhetin për kulturën. Për më shumë, ky raport do të tentojë t'iu përgjigjet pyetjeve rreth buxhetit që Qeveria e Kosovës dhe entitetet e tjera publike ia ndajnë

Metodologjia

kulturës, se si ndahet në funksione ky buxhet, si ka evoluar ndarja buxhetore për kulturë përgjatë viteve, mbi çfarë kritere ndahet ky buxhet, si trajtohet sektori i pavarur i kulturës nga politikat buxhetore publike, dhe çfarë janë sfidat me të cilat ballafaqohet sektori publik dhe ai i pavarur kulturor në aspektin buxhetor dhe në relacion me institucionet qeveritare.

Meqë qëllimi kryesor i këtij punimi është hulumtimi i politikave kulturore të Kosovës dhe ndarjet buxhetore në nivele të ndryshme dhe në funksione të ndryshme ekonomike për kulturën, fokusi primar ishte në hulumtimin e dokumenteve zyrtare rreth këtyre temave.

Dokumente si legjislacioni në fuqi – duke filluar nga ligjet deri tek vendimet e ministrave – janë analizuar. Përpos legjislacionit, janë analizuar edhe dokumentet strategjike, ku përcaktohen politikat publike. Mbi të gjitha, janë analizuar buxhetet e Republikës së Kosovës, meqë politikat publike dhe rëndësia që iu jepet atyre nga institucionet qeveritare shihet më së miri në buxhetin e alokuar për atë fushë. Intervistat dhe fokus-grupet me akterë relevant janë vënë në prioritet sekondar, për faktin se politikat kulturore do të duhej të ishin të artikuluar në dokumente zyrtare. Për këtë arsye intervistat dhe fokus-grupet janë përdorur kryesisht për validimin e të gjeturave nga hulumtimi i dokumenteve zyrtare dhe për sqarimin e paqartësive eventuale në dokumente zyrtare. Në anën tjetër, këndvështrimi i këtij raporti nuk është specifik dhe subjektivi

Kufizimet e hulumtimit

i hulumtimit nuk është parë nga një perspektivë e veçantë. Kjo për faktin se vetë natyra e raportit është më shumë në identifikimin e politikave kulturore dhe analizimin e ndarjeve buxhetore për kulturë – dy këto tema të cilat janë bazë për analiza më të thella në çështje shumë më specifike. Megjithatë, në fokus janë institucionet e pavarura kulturore dhe ndarjet buxhetore për këto organizata dhe relacioni i tyre me institucionet qeveritare.

Siç u përmend edhe në hyrje të këtij raporti shumë pak raporte dhe studime janë bërë në fushën e kulturës. Nga ato pak raporte dhe studime të bëra, një pjesë e madhe e tyre kanë mungesa në të dhëna primare dhe në statistika. Si rrjedhojë, është e domosdoshme që raporti të bazohet në pjesën më të madhe në dokumente dhe të dhëna zyrtare.

Megjithatë, mungesa e raporteve të pavarura nuk është problemi më i madh. Mungesa e dokumenteve zyrtare paraqet problemin kryesor të kësaj çështjeje. Tek të dhënat e buxhetit në nivelin komunal paraqitet buxheti për Departamentin për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS), gjë e cila e pamundëson të identifikohet buxheti vetëm për kulturë në nivelin komunal. Gjithashtu, në shumë raste procesi i buxhetimit në nivel komunal nuk reflekton shpenzimet reale të departamenteve. Ka raste kur shpenzimet komunale janë të alokuara kryesisht te DKRS, edhe pse ky departament nuk shpenzon aq shumë për shpenzime komunale. Për më shumë, subvencione në shumë të konsiderueshme ka edhe në zyrën e kryetarit. Kjo linjë buxhetore,

edhe pse në zyre të kryetarit, mund të përdoret për kulturë.

Në nivelin qendror situata me buxhetin është shumë më e mirë. Aty specifikohet ndarja e buxhetit për kulturë, rini, sport dhe trashëgimi kulturore, gjë kjo e cila mundëson identifikimin më të saktë të buxhetit të alokuar për kulturë. Megjithatë, aktivitetet kulturore së fundmi nuk financohen vetëm nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), por edhe nga Ministria e Diasporës, përmes projekteve kulturore për diasporën dhe qendrave kulturore në vendet ku ka shumë mërgatë nga Kosova, dhe Ministria e Punëve të Jashtme, përmes projekteve të diplomacisë kulturore. Për më shumë, është identifikuar shpesh nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm që buxheti i destinuar për subvencione në MKRS, buxhet i cili është i destinuar për financimin e projekteve kulturore jashtë MKRS, është përdorur për të paguar stafin e MKRS¹. Të gjithë këta faktorë paraqesin kufizime në identifikimin e saktë të buxhetit dhe ndarjet specifike për kulturë.

Në fund, sa i përket dokumenteve zyrtare ku përcaktohen politikat kulturore

apo kriteret për financim të projekteve kulturore, gjendja mund të shpjegohet me fjalitë që kufizimet e hulmtimit janë njëkohësisht edhe të gjeturat e këtij hulmtimi. Kjo e bën këtë hulmtim sa të lehtë, për faktin që nuk ka shumë të hulmtohet dhe që limitimet janë vetë të gjeturat, aq edhe të vështirë, për faktin që nuk ka shumë të dhëna të analizohen.

¹ Për më shumë, shih raportet e Auditorit të Përgjithshëm për MKRS. <http://oag-rks.org/sq/Ministrite?date=2012>

Konteksti përgjithshëm

Çdo analizë në Kosovë do të ishte e mangët sikur të mos merrej parasysh konteksti historik dhe politik.

Historia e dekadave të fundit të Kosovës është e mbushur me transformime të mëdha dhe me problematika aq të mëdha që kanë të bëjnë me vetë qenien e një popullsie dhe shtetësie. Vetëm gjatë 30 viteve të fundit, Kosova ka kaluar në katër sisteme të ndryshme shoqërore dhe politike, duke filluar nga sistemi socialist i viteve 1945–1990, në atë të sistemit shtypës dhe diskriminues jugosllav të viteve 1990, administrimit ndërkombëtar prej 1999–2008, deri në pavarësinë e shtetit të Kosovës. Kjo domosdoshmërisht ka ndikuar në formën e ndërtimit të institucioneve dhe në praktikat institucionale. Në këtë kontekst, institucionet kulturore publike gjithashtu kanë pësuar transformime të mëdha dhe mbi të gjitha kanë pasur tendencë të harrohen plotësisht apo të trajtohen si institucione të rëndësishme dytësore në raport me çështjet e tjera. Në këtë aspekt, vitet e 1990-ta ishin shkatërruese për të gjitha sferat në Kosovë. Mungesa e institucioneve shtetërore – institucionet formale ishin të pa-qasshme për shumicën shqiptare të Kosovës, ndërsa institucionet paralele ishin përgjithësisht jo-efektive në

ushtrimin e funksionit të tyre – kishte bërë që shumëçka të organizohet në baza vullnetare. Në këtë aspekt edhe sfera e kulturës u organizua vetëm në baza vullnetare të vullnetit të mirë, por nuk ishte institucionalizuar. Me fjalë të tjera, kishte mungesë pothuajse të plotë të institucioneve shtetërore që merreshin me kulturë.

Institucionet shtetërore që kishin përgjegjësi zhvillimin kulturor në Kosovë u formuan bashkë me administratën e përbashkët të përkohshme të UNMIK-ut² – qëllimi i së cilës ishte integrimi i strukturave ekzekutive, si Qeveria e Përkohshme e Kosovës, apo Presidenca e Kosovës, nën autoritetin e UNMIK-ut – në janar të vitit 2000. Në këtë rregullore u parapa që të formohet edhe Departamenti i Kulturës. Pas kësaj rregulloreje, UNMIK-u përgjatë vitit 2000 aprovoi rregullore të tjera, me të cilat zyrtarizoheshin departamentet e parapara me rregulloren Nr.2000/1, por edhe formoheshin departamente të tjera të cilat nuk ishin paraparë më herët, si Departamenti i Sportit dhe i Rinisë. Megjithatë, Departamenti i Kulturës asnjëherë nuk iu definuan përgjegjësitë dhe asnjëherë nuk u zyrtarizua. Një institucion që merret me

² Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2000/01

zhvillimin e kulturës nuk u formua deri në fund të vitit 2001, kur edhe u formuan institucionet e përkohshme vetëqeverisëse³ në Kosovë si rrjedhojë e mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare. Me formimin e institucioneve ekzekutive, u formua edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Detyrat e kësaj ministrie u përcaktuan në gjashtë rreshta, tri prej të cilave përcaktonin përgjegjësitë për Rini dhe Sport, dy rreshta përpërgjegjësitë e përgjithshme, dhe një për kulturë, në të cilën theks të veçantë i jepej trashëgimisë kulturore. Rregullorja e cila krijoi institucionet e përkohshme vetëqeverisëse do të ndryshonte tetë herë deri në vitin 2008, kryesisht për të akomoduar ministrinë e reja të cilat krijoheshin në ndërkohë, por përgjegjësitë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve mbetën ato që ishin përcaktuar në vitin 2001.

Institucionet kulturore publike, si Qendra Kinematografike e Kosovës, teatrot, muzetë, Filarmonia, veprimtaritë botuese, Ansambli Shota, dhe të tjera nuk kishin status të definuar ligjor. Përveç legjislacionit i cili krijonte dhe përcaktonte përgjegjësitë e MKRS, nuk ekzistonte asnjë dokument tjetër ligjor në lidhje me kulturën. Ligji i parë që

u mor me këto institucione ishte Ligji për Kinematografinë i aprovuar në vitin 2004. Pastaj një mori ligjesh u aprovuan në mes të vitit 2005 dhe 2006, si ligji për teatrot (2005), ligji për institucionet e kulturës (2006), ligji për filarmoninë (2006), ligji për trashëgiminë kulturore (2006), dhe ligji për veprimtarinë botuese dhe librin (2006). Gjithë këto ligje duket që më shumë ishin rrjedhojë për zgjidhjen e problemit të statutit ligjor të këtyre institucioneve kulturore publike sesa përcaktimin e ndonjë politike publike në raport me kulturën.

Përveç ligjeve të cekura më lartë, nën administratën e UNMIK nuk ishte aprovuar asnjë udhëzim administrativ i vetëm në lidhje me kulturën⁴. Të gjitha këto reflektojnë mungesë të madhe të interesimit nga ana e UNMIK-ut për sektorin e kulturës. Për më shumë, në 56 raportet e UNMIK-ut për Këshillin e Sigurimit në Kombet e Bashkuara⁵ prej vitit 1999 deri më tani, asnjëherë nuk përmendet kultura, përkundër faktit që në këto raporte kanë numër të madh të informatave në shumë aspekte të tjera shoqërore, duke filluar nga ekonomia,

4 Shih udhëzimet administrative të kohës së UNMIK-ut në <http://www.unmikonline.org/regulations/unmik-gazette/02english/Econtents.htm>

5 Për më shumë, shih raportet e UNMIK në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në <http://www.unmikonline.org/Pages/UNMIK%20Key%20documents.aspx>

privatizimi, ndërtimi i institucioneve demokratike, mediat, e deri te numri dhe lloji i krimeve. E vetmja fushë e kulturës ku UNMIK-u kishte interesim ishte trashëgimia kulturore – e cila gjithashtu është tema e vetme mbi të cilën raportohet nga UNMIK-u, por vetëm pas trazirave të marsit të vitit 2004 kur një pjesë e madhe e kishave ortodokse serbe dhe të tjera lokalitete të trashëgimisë kulturore ishin dëmtuar. Pra, edhe ky interesim i UNMIK-ut për trashëgiminë kulturore nuk ishte si rrjedhojë e interesimit për kulturën, por si pjesë e politikës ndër-etnike dhe si pjesë e të drejtave të komuniteteve minoritare. Edhe institucionet e tjera me influencë në politikën publike në Kosovë kulturën nuk e kanë pasur në listë të prioriteteve. E këtu vlen të përmendet shembulli i Bankës Botërore, e cila ka bërë pesë studime⁶ të detajuara rreth shpenzimeve publike edhe konfiguracionin institucional. Në këto studime të periudhave të ndryshme të Kosovës së pasluftës bëhet një rishikim i shpenzimeve dhe institucioneve publike. Megjithatë, në 780 faqe të këtyre studimeve, fjala “kulturë” përmendet hiç më shumë se 11 herë – kryesisht në

identifikimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Për të qenë real, duke marrë parasysh misionin e Bankës Botërore, nuk pritet që ky institucion të merret me çështje kulturore. Megjithatë, kjo tregon qartë interesimin e institucioneve si Banka Botërore në sektorin e kulturës, qoftë edhe prej prizmit të shpenzimit të parasë publike, gjë e cila nuk ka të bëjë pothuajse asgjë direkt me kulturën.

6 Kosovo: Public Expenditure and Institutional Review Volume I, 2006, Kosovo: Public Expenditure and Institutional Review Volume II, 2006, Kosovo: Public Expenditure Review, 2010, Kosovo: Policy Note on Public Investment Management, 2007, Kosovo: Selected Issues in Fiscal Decentralization, 2007

Orientimi Strategjik Kulturor

Ndonëse pas shpalljes së pavarësisë në shkurt 2008 të gjitha kompetencat u transferuan tek institucionet Kosovare, qasja qeveritare ndaj kulturës nuk ndryshoi shumë.

Kultura mbetet në margjina të politikave publike dhe mendësia që kultura është vetëm barrë për buxhetin dhe ekonominë nuk është që ka ndryshuar shumë. Qeveria e Kosovës ende nuk ka një Strategji për Kulturën⁷, strategji e cila do të kanalizonte shpenzimet publike për kulturën në baze të disa objektivave dhe qëllimeve. Në mungesë të një strategjie të tillë, shpenzimet publike vazhdojnë të mbeten kaotike, dhe përgjithësisht të orientuara në baza të politikave ditore. Në mungesë të dokumenteve strategjike veçmas për kulturën, apo së paku për MKRS-në, objektivat strategjike kulturore duhet gjetur në dokumente të tjera strategjike qeveritare. I vetmi dokument, i cili është gjithashtu konsistent, pasi që ka raste kur institucionet publike bëjnë publikim e ndonjë dokumenti strategjik vetëm për një vit, është Korniza Afaftmesme e Shpenzimeve (KASH).

⁷ Sipas z. Kamuran Goranci, drejtor i departamentit të kulturës në MKRS, Kosova kishte një strategji të kulturës të aprovuar në vitin 2003, mirëpo kjo strategji është aplikuar shumë pak. Për më shumë, kjo strategji nuk mund të gjendet online dhe ekzistojnë vetëm në disa kopje të fundit diku në arkivat e MKRS.

KASH bën planifikimin në vija të trasha të aktiviteteve shtetërore me implikime buxhetore në periudhë dyvjeçare. Ky dokument publikohet çdo vit dhe përfshinë azhurnimet e të dhënave dhe potencialisht edhe ndryshimin strategjik të institucioneve publike.

Në lidhje me orientimin strategjik kulturor edhe KASH është në linjë me diskursin publik për vëmendjen institucionale ndaj kulturës.

Përgjithësisht, kultura ka një vend të vogël dhe të jo fort të rëndësishëm në KASH. Në KASH 2006–2008, KASH-i më i vjetër që do të analizohet në këtë raport, sektorin e kulturës e analizon në të njëjtin grup me arsimin. Edhe në këtë nëngrupim, theksi vihet tek arsimi. Për të kuantifikuar këtë, arsimi në këtë nëngrupim është relativisht thukët i elaboruar, në total prej 7 faqe, ndërsa kultura është e elaboruar në terma gjeneralë dhe merr jo më shumë së 2 faqe. Ndërsa, pjesë e projekteve për kulturë parashiheh ndërtimi i Qendrës për Balet dhe Opera – një projekt i cili ishte në listën e projekteve kapitale të MKRS-së deri në ditët e sotme, por ndërtimi i të cilit kurrë nuk kapërfunduar. Ndërsa në listën e projekteve të nëngrupimit për kulturë dhe arsim, shumica dërmuese e

projekteve i takon fushës së arsimit, e një pjesë e madhe e atyre pak projekteve për kulturë i takojnë Kategorisë 2 dhe 3, që sipas KASH do të thotë që këto projekte janë të prioriteteve dytësore apo që pritet të financohen vetëm nga donatorët, por jo nga Buxheti i Kosovës. Në fund, vetë pjesa e kulturës elaborohet kryesisht në fushën e trashëgimisë kulturore, ndërsa pjesa tjetër e kulturës nuk përmendet në asnjë pikë.

KASH-i i vitit 2006-2008, megjithatë, është shumë më i mirë për kulturën në krahasim me KASH-in për vitin 2009-2011, ku kultura elaborohet vetëm në një rresht në kategorinë 'të tjera' bashkë me kategoritë e tjera si ambienti, turizmi, dhe siguri i kushteve për infrastrukturë të Qeverisë së Kosovës.

Një vit më vonë, situata në dokumentet strategjike të Kosovës për kulturën fillon të përmirësohet. Sektori për kulturën kthehet në listën e sektorëve ku analizohet gjendja dhe vendosen objektivat strategjike. Gjithashtu konstatohet që "është bërë shumë pak për institucionet e rëndësishme si janë filarmonia, opera, baleti, ansambli shota, teatri dhe muzetë e që janë brumi i zhvillimit të kulturës Kosovare."⁸ Objektivat strategjike konsiderojnë

mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si objektivin kryesor, ndërsa objektivat tjera kanë të bëjnë me ndërkombëtarizimin e sportit, apo zhvillimin e infrastrukturës fizike dhe infrastrukturës ligjore për zhvillimin e kulturës. Ndërsa projekti i vetëm i identifikuar për realizimin e zhvillimit të infrastrukturës për zhvillimin e kulturës është ndërtimi i shtëpisë teatër dhe opera "Ibrahim Rugova", pra tashmë me emër tjetër, por i cili kurrë nuk u përfundua. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të ceket se 'brumi' i zhvillimit të kulturës konsiderohet të jenë filarmonia, opera, baleti, Ansambli Shota, teatri dhe muzetë. Duke pasur parasysh që sektori i pavarur i kulturës ishte, dhe vazhdon të jetë, 'prodhuesi' më i madh i kulturës në Kosovë, lënja anash e tij në rastin më të mirë reflekton mendjengushtësi.

Qasja e institucioneve publike ndaj kulturës vazhdon të mbetet e njëjtë edhe për KASH të viteve 2011-2012 dhe 2012-2013. Objektivi kryesor vazhdon të mbetet investimi në infrastrukturë si mënyrë për zhvillimin e kulturës, dhe nënkuptohet fokusi për institucionet publike kulturore. Gjithashtu, pretendohet për rritje të buxhetit për kulturën. Nuk është deri në vitin 2014 që qasja e institucioneve publike të Kosovës fillon

⁸ Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013

të ndryshojë, së paku në dokumentet strategjike, në favor të mbështetjes edhe të sektorit të pavarur të kulturës. Si suksese të MKRS-së identifikohet promovimi i skenës kulturore të Kosovës në ngjarjet e mëdha kulturore në botë, si pjesëmarrja në ekspozitën ndërkombëtare të arkitekturës në Bienalen e Venedikut apo në festivalin e xhazit Montreux Jazz Festival. Gjithashtu, si objektivë e parë listohet për herë të parë përkrahja e institucioneve publike, përkrahja e kulturës së pavarur si dhe avancimi i diplomacisë kulturore. Mënyra e përkrahjes vazhdon të mbetet kryesisht investimi në infrastrukturën fizike, por shtohet edhe përkrahja e krijimtarisë dhe kreativitetit kulturor të organizatave të pavarura kulturore. Kjo qasje e KASH 2014–2016 vazhdohet edhe në KASH 2015–2017. Përpos vazhdimit të kësaj qasje, fokusi në investimin në infrastrukture fizike gjithashtu zbehet ndërsa potencohet më shumë përkrahja për aktivitetet kulturore.

TABELA 1: Objektivat Statëgjike për Kulturën sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve.

2006	2011	2012
1. Të përparojë infrastrukturën legjislativë dhe instrumentet e tjera që do të shërbejnë si bazë për krijimin e kushteve më të mira për lokacionet të rëndësishme arkeologjike	1. Përkujdesjen dhe vlerësimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, gërmime dhe hulumtime arkeologjike, legjislacioni për ruajtjen e trashëgimisë sipas standardeve bashkëkohore në harmoni të plotë me Bashkimin Europian	1. Përkrahja dhe lobimi për ndërkombëtarizimin e sportit, ndërtimi i infrastrukturës sportive
2. Të mirëmbajë dhe mbrojë trashëgiminë kulturore Kosovare me vlerë arkeologjike, arkitektura dhe shpirtërore	2. Përkrahja për lobim dhe ndërkombëtarizim të sportit, ndërtimi i infrastrukturës sportive	2. Përkujdesja dhe vlerësimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, gërmimeve dhe hulumtimeve arkeologjike, legjislacionit për ruajtjen e trashëgimisë sipas standardeve bashkëkohore në harmoni të plotë me Bashkimin Europian
3. Të ruhet identiteti kulturor, gjuhësor dhe kombëtar i diasporës Kosovare	3. Infrastruktura për zhvillimin e kulturës kosovare	3. Infrastruktura për zhvillimin e kulturës kosovare
4. Të institucionalizohet sporti dhe të forcohen marrëdhëniet përbrenda Kosovës dhe me jashtë	4. Plani Kosovar i Veprimit për Rini	4. Plani Kosovar i Veprimit për Rini
5. Informimi, arsimi dhe orientimi i rinisë në sfera të ndryshme jetësore	5. Infrastruktura ligjore	5. Infrastruktura ligjore

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

2013	2014	2015
1. Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe plothësi i infrastrukturës ligjore në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit	1. Përkrahja e institucioneve publike të kulturës, përkrahja kulturës së pavarur si dhe avancimi i diplomacisë kulturore	1. Përkrahja e institucioneve publike të kulturës, përkrahja e kulturës së pavarur, si dhe avancimi i diplomacisë kulturore
2. Përkrahja e sportit dhe kulturës kosovare, përmirësimit të infrastrukturës fizike dhe përkrahjes në ndërkombëtarizimin e sportit	2. Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore	2. Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
3. Zhvillimi i trashëgimisë kulturore në pajtim me standardet bashkëkohore dhe praktikat më të mira të Bashkimit Europian	3. Zhvillimi dhe avancimi i sportit cilësor, masivizimi dhe ndërkombëtarizimi i sportit, si dhe modernizimi i infrastrukturës sportive	3. Zhvillimi dhe avancimi i sportit cilësor, masivizimi dhe ndërkombëtarizimi i sportit si dhe modernizimi i infrastrukturës sportive
4. Përkrahja e rinisë përmes zbatimit të Planit kosovar të veprimit për rini	4. Fuqizimi dhe integrimi i të rinjve në proceset vendim-marrës dhe në politikë-bërje	4. Fuqizimi dhe integrimi i të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe në politikë-bërje
5. Përkrahja e Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e përafërta për anëtarësim në Organizatën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale (WIPO)	5. Fuqizimi i sistemit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta	5. Fuqizimi i sistemit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta

Buxheti Qendror për Kulturën


Në këtë kapitull do të analizohet buxheti për kulturën në nivelin qendror. Niveli qendror këtu nënkupton MKRS-në dhe Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë (KKTK), si të vetmet institucione qendrore që merren me kulturë.

Aktivitetet kulturore së fundmi i kanë financuar edhe Ministria e Diasporës dhe Ministria e Punëve të Jashtme, siç u shpjegua te kapitulli i limitimit të hulumtimit, por meqë identifikimi i linjave buxhetore për aktivitete kulturore brenda këtyre dy ministrive është pothuajse i pamundshëm, në këtë kapitull vetëm MKRS dhe KKTK do të merren parasysh.

Qëllimi i këtij kapitulli është që të identifikohet vendi i kulturës dhe rëndësia e saj në politikat e përgjithshme qeveritare. Me dekonstruktimin e buxhetit për kulturë në sa më shumë pjesë, ky kapitull gjithashtu synon të identifikojë politikat specifike kulturore të institucioneve që merren me kulturë.

Në grafikën djathtas mund të shihet buxheti i kombinuar për MKRS dhe KKTK, ky buxhet si përqindje ndaj total buxhetit qendror të Republikës së Kosovës, buxheti i kombinuar vetëm i departamentit për kulturë në MKRS dhe KKTK, dhe ky buxhet si përqindje ndaj total buxhetit qendror të Republikës së Kosovës. Së pari, buxheti për KKTK është futur në kombinim me buxhetin për kulturë dhe buxhetin e MKRS-së për arsye se ky institucion ka pothuajse qëllimin e njëjtë si të Departamentit për Trashëgimi Kulturorë, brenda MKRS. Për të mos krijuar paqartësi dhe për të marrë shifrën sa më të saktë të buxhetit për kulturë, atëherë përfshirja e KKTK-së në buxhetin për kulturë dhe MKRS është e domosdoshme. Gjithashtu, duhet pasur parasysh që Departamenti për Trashëgimi Kulturorë është formuar vetëm në vitin 2010, dhe analizimi i një buxheti veçmas për trashëgimi kulturore përpara kësaj date është i pamundshëm, rrjedhimisht përfshirja e KKTK-së i bën më lehtë të kuptueshme dhe të analizueshme të dhënat.

Buxheti për MKRS në numra absolut është rritur pothuajse për çdo vit prej 2002, duke filluar nga 5.1 milionë euro në vitin 2002 në 20.2 milionë euro në vitin 2014. Një rritje e papritshme mund të shihet gjatë viteve 2003–2006. Kjo rritje vjen si pasojë e dy ngjarjeve që nuk janë të lidhura direkt

GRAFIKA 1: Buxheti për MKRS dhe KKTK**Burimi: Buxheti i Kosovës**

me kulturën. E para lidhet me ngjarjet e traziravetëmarsit të vitit 2004, kur pas njëpakënaqësisë të madhe sociale dhe ngriteje të tensioneve etnike shpërthyen trazira dhe si rrjedhojë u dogjën shumë kisha ortodokse dhe tjera objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore. Institucionet e asaj kohe, pra Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe administrata e UNMIK-ut, vendosën që të gjitha dëmet e shkaktuara të riparohen dhe që objektet të restaurohen me fonde të buxhetit të Kosovës. Kjo si rrjedhojë edhe rriti buxhetin për MKRS-së, edhe pse puna kulturore e MKRS-së nuk kishte ndryshuar shumë. Ngjarja e dyte ka të bëjë me aprovimin e Ligjit Mbi Materialin Arkivor Dhe Arkivin⁹ në vitin 2003 me të cilin arkivat e Kosovës bëhen pjesë e MKRS. Rrjedhimisht, kostoja ekstra e arkivave të Kosovës ngriti edhe buxhetin e MKRS, edhe pse materiali arkivor dhe arkivat pothuajse nuk kanë të bëjnë me kulturën aspak. Mirëpo, në vitin 2006 ndodhi ndryshim-plotësimi i ligjit mbi materialin arkivor dhe arkivin¹⁰ ku përgjegjësia për arkivat u transferua prej MKRS te zyra e kryeministrit. Kjo si rrjedhojë edhe ka kontribuar në uljen e buxhetit për MKRS gjatë vitit 2006 e tutje.

Indikator më i saktë për trendin e buxhetit për MKRS do të ishte përqindja e buxhetit të kësaj ministrie kundrejt buxhetit total të nivelit qendror të Republikës së Kosovës. Kjo përqindje, siç shihet me vlijë të kuqe në grafikë, ka rënie prej viti 2002 deri në vitin 2006, dhe ngritje prej vitit 2006 deri në vitin 2014. Rënia vjen për dy arsye të përmendura në paragrafin e mësipërm, dhe gjithashtu si rrjedhojë e bartjes së më shumë kompetencave nga administrata e UNMIK-ut te Qeveria e Përkohshme e Kosovës. Bartja e kompetencave nënkupton më shumë përgjegjësi dhe më shumë hapësirë për Qeverinë e afërhershme për të udhëhequr me politikën publike. Kjo u reflektua në uljen relative të buxhetit për MKRS në relacion me institucionet e tjera qendrore.


Ndërsa, prej vitit 2007 dhe me shpalljen e pavarësisë në vitin 2008, morën fund transferimet e kompetencave dhe filloi një lloj stabiliteti institucional dhe gjithashtu MKRS filloi të ketë më shumë vëmendje qeveritare, çka çoi te rritja e buxhetit të MKRS prej rreth 1.05 për qind të buxhetit total qendror të Republikës së Kosovës në vitin 2008 në 1.69 për qind në vitin 2014.

9 UNMIK Rregullore Nr. 2003/20

10 UNMIK Rregullore Nr. 2006/40

Megjithatë, për të parë se sa nga kjo rritje e buxhetit ka shkuar për kulturën, duhet që buxheti i MKRS-së të zbërthehet në buxhetin për kulturë dhe trashëgimi kulturore, rini dhe sport. Rritja e buxhetit për kulturë mund konsiderohet modeste dhe në proporcion të njëjtë me rritjen e përgjithshme të buxhetit të Kosovës. Në vitin 2002, buxheti për kulturën ishte jo më i madh se 2.9 milionë euro, ndërsa 12 vite më vonë, në vitin 2014, buxheti për kulturën ishte rritur në 9.1 milionë euro. Në përqindje ndaj totalit, në vitin 2002 kultura përbënte 1 përqind të buxhetit total, ndërsa në vitin 2014 kishte rënë në 0.76 përqind të totalit. Kjo përqindje ka qenë relativisht stabile përgjatë të gjithë viteve ndërmjet, duke u luhatur nga 0.68 për qind në 0.73 për qind, gjë e cila tregon që realisht buxheti për kulturën dhe trashëgiminë kulturore nuk ka pasur ngritje përpos ngritjes proporcionale të ngritjes së buxhetit të përgjithshëm të Kosovës. Gjithashtu, shihet që edhe pse në vitin 2010 u formua KKTK, formimi i këtij institucioni nuk është që ndikoi në ngritjen e buxhetit për kulturën. Ndërsa nga ngritja e buxhetit për MRKS nuk ka fituar Departamenti i Kulturës, por departamenti i Rinisë dhe Sporteve.

GRAFIKA 2: Buxheti i Departamentit për Kulturës dhe Trashëgimi Kulturore në MKRS




Burimi: Buxheti i Kosovës

Që nga rritja e buxhetit për MKRS-në kanë përfituar më shumë departamentet për sport dhe rini, shihet edhe nga grafika numër 2 dhe 3. Edhe pse ka pasur një rritje nga 3.8 milionë euro në vitin 2006 në 8.9 milionë euro në vitin 2014, përqindja e buxhetit për departamentin e kulturës dhe trashëgimisë kulturore si përqindje e total buxhetit të MKRS-së ka rënë nga 59.7 për qind në vitin 2006 në 44.4 për qind në vitin 2014. Ndërsa investimet kapitale të ndara për kulturën në periudhën 2004-2009 varionin nga 55.8 për qind në 64.5 për qind të të gjitha investimeve kapitale të MKRS; mirëpo pas viti 2009 kjo shifër ka pësuar rënie e cila varion nga 11.1 për qind në 15.2 për qind. Shifrat për investimet kapitale janë nga planifikimet buxhetore, gjë e cila shpjegon rritjen në buxhetin për investime kapitale në vitin 2008-2009 kur ishte planifikuar ndërtimi i sallës së operës dhe baletit. Përkundër faktit që shifrat në grafikën numër 3 janë të planifikimit buxhetor, ndryshimi prej shifrave të planifikimit buxhetor dhe raportimit buxhetor përpos viteve 2008-2009, nuk mund të kenë ndryshuar aq shumë sa të ndryshojë edhe interpretimin e këtyre të dhënave.



Një prizëm tjetër i shikimit të buxhetit të kulturës është fokusimi në kategorizimet ekonomike të buxhetit për kulturën. Është e qartë që Qeveria e Kosovës prej vitit 2007 është fokusuar shumë në përmirësimin e infrastrukturës, rrjedhimisht energjitë dhe resurset kryesore i ka alokuar në ndërtimin dhe përmirësimin infrastrukturor të Kosovës¹¹. Kësaj mendësie nuk i kishte shpëtuar as sektori i kulturës. Në grafikën numër 3 shihet që nga ngritja e buxhetit për MKRS dhe KKTK më së shumti kanë përfituar shpenzimet kapitale. Në vitin 2006, vetëm rreth 16 për qind e buxhetit ndahej për investime kapitale, ndërsa në vitin 2014 kjo shifër u rrit në rreth 52 për qind. Duke e ditur që kultura në Kosovë financohet në pjesën më të madhe përmes linjës së subvencioneve, janë pikërisht subvencionet të cilat nuk kanë përfituar edhe aq shumë nga rritja e buxhetit për MKRS-në. Ndonëse investimet në infrastrukturë janë të nevojshme për zhvillimin kulturor, fokusimi në masë të madhe vetëm në investime në infrastrukturë për zhvillimin e kulturës nuk paraqet politikë të mirë zhvillimore për kulturën. Duke e pasur parasysh natyrën e fushës së kulturës, investimi më i madh në resurset njerëzore dhe në

¹¹ Për më shumë rreth politikave strategjike të Kosovës, shih Kornizat Afatmesme të Shpenzimeve

GRAFIKA 3: Investimet kapitale të MKRS-së në kulturë

Burimi: Buxheti i Kosovës

ngjarjet cilësore kulturore do të ndikonin shumë më pozitivisht në zhvillimin e fushës së kulturës.

GRAFIKA 4: Ndarja funksionale e buxhetit të MKRS dhe KKTK**Burimi: Buxheti i Kosovës**

Buxheti Lokal për Kulturën

Karakteristikat e buxheti lokal, pra buxheti i ndarë nga komunat e Kosovës, nuk dallon shumë nga buxheti i nivelit qendror.


Trendët e rritjeve buxhetore janë të ngjashme. Po ashtu, edhe ndarjet ekonomike të buxhetit në nivel lokal ndjekin shembullin e nivelit qendror: me rritjen e buxhetit, jo proporcionalisht rriten investimet kapitale, pra investimet në infrastrukturë. Mirëpo, problematike për nivelin komunal është ndarja e buxhetit për kulturë, për arsye se ndarja buxhetore në nivelin më të thellë behet në nivel drejtorish. Pothuajse të gjitha drejtoritë në komunat e Kosovës janë Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS)¹², gjë e cila e bën të pamundur ndarjen e buxhetit vetëm për fushën e kulturës.

Në aspektin e vlerës numerike, buxheti i drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në nivelin komunal ka pasur rritje prej afro 2 milion euro në vitin 2007 në 11.3 milion euro në vitin 2014. Kjo rritje enorme megjithatë është në proporcion me rritjen e buxhetit të përgjithshëm të nivelit komunal dhe nuk reflekton interesim më të madh të komunave rreth çështjeve kulturore, sportive apo të rinisë. Kjo

vërehet më se miri ku buxheti i drejtorisë së kulturës, rinisë dhe sporteve shihet si përqindje e buxhetit të përgjithshëm të komunës. Kjo përqindje nuk ka luajtur shumë ndër vite, megjithëse vërehet një trend i lehtë ngritje. Në vitin 2007 kjo përqindje ishte 2.1 përqind, ndërsa në vitin 2014 ishte rritur në 3 përqind, pra 0.9 pikë të përqindjes më shumë.

Edhe në nivelin lokal, shihet qartë që politikat publike në fushën e kulturës nuk janë më ndryshe se në fushat e tjera: kryesisht investim në infrastrukturë. Megjithatë, për dallim prej nivelit qendror, të dhënat për nivelin lokal fillojnë nga viti 2007, çka e vështirëson përcjelljen e një trendi më afatgjatë dhe të shihen efektet e proceseve politike. Në vitin 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, i cili i transferoi shumë kompetenca te niveli komunal. Ky faktor, bashkë me prioritetet e qeverisë prej viteve 2007 e tutje, bën që investimet kapitale të rriten dukshëm. Kjo mund të shihet edhe në grafikën numër pesë, ku shihet qartë që në vitin 2007 investimet kapitale përbënin diku rreth 17 përqind të shpenzimeve komunale, ndërsa në vitet në vazhdim shpenzimet kapitale

¹² Në gjashfë komuna kultura është pjesë e drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës. Këto komuna janë Komuna e Kaçanikut, Novobërdës, Shtërpcës, Deçanit, Malishevës, dhe Dragashit.

GRAFIKA 5: Buxheti i departamentit për Kulturë, Sport dhe Rini në komuna**Burimi: Buxheti i Kosovës**

rriten për të arritur mbi 50 përqind në vitin 2014. Ndërsa pyetjes se në cilën fushë kanë shkuar investimet kapitale të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në grafikun numër gjashtë shihet që pak më shumë se gjysma e investimeve ka shkuar për kulturën.


Megjithatë, duhet cekur që shumë nga këto investime shumëfunksionale, siç janë për shembull qendrat multifunksionale të cilat shërbejnë dhe janë të destinuara për më shumë se një fushë. Andaj, edhe përqindja mund të konsiderohet më e ulët, apo më mirë të thuhet, cilësia e investimeve kapitale në fushën e kulturës nuk është që do të ndihmojë zhvillimin e fushës së kulturës ashtu siç numrat mund të japin përshtypjen. Si shembull tjetër për këtë mund të shërbejë edhe rasti i Komunës së Novobërdës, e cila në 4 vitet e fundit investon linjën buxhetore të investimeve kapitale të Drejtorisë së Kulturës në pjesën më të madhe vetëm në blerjen e librave për bibliotekë. Është e paqartë se si një investim i tillë i vetëm ndihmon zhvillimin kulturor.

Në fund, vlen të përmendet efekti i madhësisë së komunës në shpenzimet për kulturë. Ka një korelacion pozitiv në mes të madhësisë së buxhetit

të komunës dhe përqindjes që ajo komunë shpenzon për DKRS: sa më i madh që të jetë buxheti i një komune, aq më e madhe do të jetë përqindja që ajo komunë shpenzon për DKRS. Kjo vjen si rezultat i shumë faktorëve. Ndër faktorët kyç që ndikojnë në këtë fenomen është arritja e ‘ekonomisë së shkallës’ në shërbimet komunale, apo rritjes së efikasitetit të komunës në ofrimin e shërbimeve. Sa më e madhe të jetë një komunë, aq më efikase në ofrim të shërbimeve ajo bëhet. Pra, në një komunë të madhe, një shërbyes civil i shërben më shumë njerëzve sesa një shërbyes civil në një komunë më të vogël. Kjo vjen si rrjedhojë që disa funksione të komunës nuk mund të hiqen në proporcion me popullsinë – një komunë duhet të ketë zyre të prokurimit, pa marrë parasysh sa e vogël të jetë ajo¹³. Por, megjithatë, nuk duhet neglizhuar faktorin tjetër, që madhësia e komunës është në korelacion të drejtë me urbanizimin e asaj komune dhe urbanizimi është në korelacion të drejtë me prodhimin e aktiviteteve kulturore.

¹³ Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 10/46 përcakton që një komunë duhet të ketë 50 shërbyes civil si numër bazë, ndërsa pjesa tjetër e shërbyesve civil vjen si rrjedhojë e madhësisë së komunës. Në komuna të vogla, numri i shërbyesve civil që domosdoshmërisht një komunë duhet pasur është më i madh në aspektin e përqindjes se në një komunë më të madhe.

GRAFIKA 6: Ndarja funksionale e buxhetit të departamentit për Kulturë, Sport dhe Rini në Komuna




Burimi: Buxheti i Kosovës

Një trend i ngjashëm ndodh kur të krahasohet edhe buxheti për subvencione dhe investime kapitale – si dy linja buxhetore të ndara direkt për aktivitete kulturore në vend se të jene për burokracinë institucionale siç është rasti me pagat dhe mëditjet, shërbimet komunale apo mallrat dhe shërbimet – si përqindje e buxhetit të DKRS-së për atë komunë. Edhe ky korelacion vjen si rezultat i ‘ekonomisë së shkallës’ te komunat. Është e domosdoshme të ceket këtu që politika e Qeverisë së Kosovës që të krijojë komuna të reja¹⁴, ndikon negativisht në buxhetin e sektorit të kulturës në nivelin komunal.


14 Për më shumë rreth efektit të krijimit të komunave të reja dhe politikës së Qeverisë së Kosovës për krijimin e komunave të reja, shih raportin nga Instituti GAP, Themelimi i Komunave të Reja në Kosovë: Implikimet buxhetore dhe vefë qëndrueshmëria financiare, 2013. http://www.institutigap.org/documents/24767_KomunateReja.pdf

GRAFIKA 7: Ndarja funksionale e buxhetit të departamentit për Kulturë, Sport dhe Rini në Komuna




Burimi: Buxheti i Kosovës

GRAFIKA 8: Relacioni në mes të madhësisë së komunës dhe shpenzimeve për kulturë, rini dhe sport



Shënim: Komuna e Prishtinës përkundër veçantisë së saj (outlier) është përfshirë në listë të komunave për shkak të statusit të saj të pazgjdhur të kryeqytetit.

GRAFIKA 9: Relacioni në mes të madhësisë së komunës dhe shpenzimeve për kulturë, rini dhe sport



Shënim: Komuna e Prishtinës përkundër veçantisë së saj (outlier) është përfshirë në listë të komunave për shkak të statusit të saj të pazjidhur të kryeqytetit.

Buxheti për kulturën në rajon dhe Evropë

Ashtu siç varion kultura qeverisëse dhe politikat publike ndër shtete, edhe buxheti shtetëror për kulturën ndryshon në bazë të disa faktorëve që kanë të bëjnë me specifikat e një vendi.

Ndër këto karakteristika më themeloret janë madhësia e buxhetit të përgjithshëm shtetëror, apo vetë madhësia e shtetit, rëndësia e kulturës në politikën publike, niveli i institucionalizimit publik i aktiviteteve kulturore, dhe niveli i zhvillimit ekonomik dhe njerëzor të atij vendi. Për shembull, vendet skandinave si Norvegjia, Danimarka dhe Suedia, shpenzojnë mbi 300 euro për kokë banori në fushën e kulturës, në krahasim me vendet e ish-Bllokut Sovjetik dhe Europës Lindore, si Moldavia, Gjeorgjia dhe Azerbajgjani, të cilat shpenzojnë nën 10 euro për kokë banori – diferencë kjo e cila mund t'i atribuohet kryesisht madhësisë së ndryshme të buxhetit të shteteve, ku vendet skandinave kanë buxhete shtetërore enorme krahasuar me vendet e Europës Lindore dhe ish-Bllokut Sovjetik. Shembull tjetër mund të jetë gjithashtu rasti i Monakos, shtet ky i cili shpenzon mbi 1,500 euro për kokë banori, apo rreth 1,000 euro më shumë se vendet skandinave. Duke pasur

parasysh natyrën e këtij vendi të vogël bregdetar, por të pasur, si dhe faktin që kultura dhe turizmi në këtë vend janë shumë të ndërlidhura së bashku, atëherë edhe shpenzimet e mëdha për kulturë shpjegohen në bazë të specifikave të këtij vendi. Rrjedhimisht, diskrepancat në të dhënat e mëposhtme duhen të shihen dhe gjykohen brenda kontekstit.

Në përgjithësi, buxheti kulturor për kokë banori në Kosovë është ngritur relativisht shpejt, por siç u analizua edhe në kapitujt më lartë, kjo ngritje vjen prej rritjes së buxhetit të përgjithshëm. Me gjithë ngritjen, Kosova është ndër vendet që shpenzon më së paku për kokë banori në rajon dhe Europë. Në vitin 2011, Kosova shpenzoi më së paku, rreth 6.3 euro për kokë banori, më pak se Moldavia, Gjeorgjia, Maqedonia, dhe Serbia (vetëm niveli qendror), të cilat shpenzuan 7.7, 9.3, 24.5, dhe 15 euro për kokë banori respektivisht. Përderisa një pjesë e diferencës ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë mund t'i atribuohet projektit multi-milionësh maqedonas “Shkupi 2014”, i cili ka rritur kësajoj edhe të dhënat për shpenzimet në kulturë, krahasimi ndërmjet vendeve tjera si Moldavia, Serbia apo Gjeorgjia, të cilat ndajnë një kontekst të ngjashëm të zhvillimit ekonomik, historik dhe

institucional, është indikator i mirë për prioritetet shtetërore karshi kulturës. Indikator tjetër është gjithashtu edhe përqindja e buxhetit të përgjithshëm të ndarë për kulturë, ku Kosova është prapë ndër vendet që ndanë më së paku për kulturë. Me 0.8 për qind të buxhetit të përgjithshëm të ndarë për kulturë në vitin 2011, Kosova shpenzonte më shumë vetëm se Greqia dhe Irlanda, 0.37 dhe 0.4 për qind respektivisht – shifra këto që me siguri mund t'i atribuohen krizës ekonomike të euros dhe masave të rrepta të kursimeve në Greqi dhe Irlandë.

TABELA 2:

Vendi	2005	2009	2011	% e buxheteve publike	Baza e krahasimit (viti; definicion; burimi, përveç "Compendium")
	€ për kokë banori	€ për kokë banori	€ për kokë banori		
Kosova	2.7*	5.4	6.3	0.8	*) 2007
Shqipëria	5.85			1	
Austria	250	274	273*	1.55	*) 2011
Azerbaigjani	11	N/A	39*	ca. 2*	*) 2011
Bulgaria	18	29	N/A	1.72*	*) 2009
Kroacia	N/A	77	72*	1.48*	*) 2011
Republika Çeke	N/A	97	105	1.70*	*) 2011
Danimarka	352*	294	300*	ca. 1**	*) 2006 **) 2011 ***) 2010
Estonia	140	193	187**	3.21	*) 2001 **) 2011
Finlanda	168	177	N/A	0.99*	*) 2009
Gjeorgia	7.6	11.6	9.3	N/A	
Gjermania	97	112	117	1.67	Burimi: Kulturfi- nanzbericht 2012
Greqia	32*	N/A	45**	(0.37**)	Vetëm nivel i qen- dror *) 2006 **) 2011
Hungaria	36*	56	N/A	1.69**	*) 2004 **) 2009
FYROM			24.5	2.05	
Irlanda	34	50*	43**	0.4**	*) 2008 **) 2011
Italia	112	134	117	0.9	
Latvia	27	61	51	(1.86)	Vetëm nivel i qendr
Lituania	34*	N/A	44**	(1.76**)	Vetëm nivel i qen- dror *) 2004 **) 2012
Moldavia	4.5	7.6	7.7	N/A	*) 2001
Monaco	946	1417	1610*	6.71	*) 2011
Hollanda	229	267	267*	1.51*	Ministria e Kulturës *) 2011
Norvegjia	380	389	446	1.53	*) 2002
Polonia	29	48	52*	(0.5**)	*) 2011 **) Vetëm nivel i qendr
Portugalia	76	76	69	0.9	
Romania	N/A	50	41	2.1	
Serbia	17	24	15*	(0.65**)	*) 2011 **) Vetëm nivel i qendr
Spanja	120	153	149	1.36	Burimi: Ministry of Culture
Suedia	220	239	278*	2.6*	*) 2011, Burimi: kulturanalys.se
Zvicra	183	207	235	1.7*	*) 2009
Ukraina	8.3	12.6	12.2**	1.7**	*) 2001 **) 2011

Burimi: Buxheti i Kosovës (kalkulim i autorit) dhe Compendium (www.culturalpolicies.net)

Buxheti për institucione publike, insentivat, dhe institucionet e pavarura

Në kapitullin për orientimet strategjike kulturore u cek fakti që institucionet qeveritare janë të fokusuara në pjesë të madhe në institucionet publike.


Institucionet publike kulturore shihen si brumi i zhvillimit të përgjithshëm të kulturës. Kjo qasje madje do të ishte e drejtë, po të mos ekzistonin institucionet e pavarura të kulturës, sikur të kishte insentiva për institucionet publike kulturore që të gjeneronin të ardhura vetanake dhe sikur të kishte barazi në ‘tregun’ kulturor ndërmjet institucioneve publike dhe të pavarura të kulturës. Institucionet publike të kulturës në Kosovë janë të diskriminuar pozitivisht kundrejt institucioneve të pavarura të kulturës. Pjesa më e madhe e buxhetit të dedikuar për përkrahjen e aktiviteteve kulturore shkon për institucionet publike të kulturës, edhe pse, jo zyrtarisht, institucionet e pavarura të kulturës janë prodhuesi më i madh dhe më cilësor artistik në Kosovë¹⁵. Grafiku më poshtë tregon qartë se në ç’masë institucionet qeveritare i favorizojnë institucionet publike karshi atyre të pavarura.

Përqindja e subvencioneve që ndahen për institucione publike kulturore varion prej minimum 60 për qind deri në 98 për qind të të gjithë subvencioneve të ndara për aktivitete kulturore. Një diskriminim i tillë në subvencionim mbyl ‘konkurrencën’ në ‘tregun’ e kulturës dhe pengon zhvillimin e mëtutjeshëm të kulturës.

Përpos shumave të mëdha të subvencioneve që institucionet qeveritare japin për institucionet publike kulturore, gjithashtu mungojnë insentivat që këto institucione të sigurojnë së paku një pjesë të financimit të aktivitetit të tyre përmes të hyrave vetanake. Insentivat për institucionet publike kulturore pothuajse janë jo-ekzistente. Në anën tjetër, jo vetëm insentivat janë pothuajse in-ekzistente, por institucionet qeveritare edhe janë të detyruara t’i financojnë institucionet publike kulturore. Sipas ligjit për teatrot¹⁶, Teatri Kombëtar është i obliguar të japë 5 premiera në vit, ndërsa financimin e bën MKRS. Gjithashtu, teatrot publike janë të obliguara me ligj të mbajnë një trupë të aktorëve dhe të stafit (numri ndryshon varësisht prej llojit të teatrit: kombëtar apo i qytetit) përgjatë gjithë kohës, të cilët edhe sikur nuk do të jepnin asnjë shfaqje, ata do të ishin të punësuar nga MKRS apo komuna

15 Pse na duhet një Strategji e Kulturës?, Forumi Kulturor, 2012.

16 Ligji Nr. 04/L – 106 për Teatrot

GRAFIKA 10: Subvencionet kulturore për institucionet publike dhe jo-publike

Burimi: Buxheti i Kosovës dhe Raporti Buxhetor i Kosovës

(varësisht a është teatër kombëtar apo i qytetit). MKRS apo komnat individuale janë gjithashtu përgjegjëse për financimin e institucioneve si, filarmonitë, ansamblet, dhe institucionet tjera kulturore.

Buxheti për institucione të ndryshme kulturore publike lë të kuptohet se mënyra së si financohen këto institucione nga MKRS apo komnat individuale i ngjason më shumë një granti institucional – mjete të cilat dhurohen për funksionimin e një institucioni, por që nuk kushtëzohen me aktivitete apo me mbajtjen e cilësisë së punës, pra grante vetëm për mirëmbajtjen e institucionit – sesa që ngjasojnë me grante për projekte të caktuara. Shuma e granteve të cilat janë dhuruar për një institucion nuk ndryshon prej vitit në vit, por mbetet e njëjtë. Sikur të financoheshin projektet, shumat me siguri se do të ishin ndryshe për secilin vit.

Në fund, edhe vet institucionet publike kulturore nuk janë shumë të lira në kontrollimin e financave të tyre. Të ardhurat që ato gjenerojnë, duhet të kthehen në buxhetin e konsoliduar të Kosovës në formën e të ardhurave vetanake të Ministrisë së Kulturës. Pavarësisht se një pjesë e madhe e institucioneve kulturore publike

gjenerojnë shumë pak të hyra që ato të hyra të konsiderohen si faktor me peshë në buxhetin qendror të MKRS apo të Republikës së Kosovës dhe që ndodh shpesh që këto të ardhura vetanake të përdoren nga vetë ai institucion apo të mos raportohen fare¹⁷, vetë fakti që të hyrat vetanake duhet të shkojnë tek MKRS dhe pastaj të derdhën në buxhetin e konsoliduar të Kosovës paraqet një disinsitivë për institucionet kulturore publike që të gjenerojnë të ardhura¹⁸. Apo më keq se atë, kjo mënyrë e menaxhimit të të hyrave vetanake mund të jetë insitivë që të hyrat vetanake të mos raportohen, gjë e cila hap mundësinë për keqpërdorim të këtyre mjeteve. Sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të hyrat vetanake të institucioneve varfëse të MKRS – të cilat përfshijnë institucione si Teatri Kombëtar, Filarmonia, Baleti, Shota, etj – kanë trend të pjerrët të rënies, gjë e cila mund të sinjalizojë që të hyrat vetanake nuk raportohen apo përdoren për aktivitetet e institucioneve

¹⁷ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka gjetur paqartësi në raportimin e të hyrave buxhetore. Ky fenomen vazhdon të jetë prezent përkundër raportimit të rregullt të ZAP mbi këtë çështje. Për më shume, shih raportet e ZAP për MKRS në <http://oag-rks.org/sq/Ministrite?date=2012>

¹⁸ Ndonëse kjo çështje edhe mund të rregullohet me Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet institucionit publik, sipas rregullës financiare 03/2010, derdha e të hyrave vetanake të institucioneve kulturore publike në buxhetin e konsoliduar të Kosovës apo në buxhetin e Komunës vazhdon të mbretërojë si praktikë në pothuajse të gjitha institucionet.


TABELA 3:

Institucioni	2014	2013	2012
Kosovafilm	10.000	10.000	10.000
Baleti	160.000	120.000	120.000
Shoia	140.000	120.000	120.000
GAK	160.000	120.000	120.000
Galeria Qafa	25.000	20.000	20.000
Teatri Kombetar	330.000	300.000	300.000
QKK	700.000	600.000	600.000
Filarmonia	240.000	220.000	220.000

Burimi: Forumi Kulturor, 2014

në kundërshtim me bazën ligjore. Në vitin 2008 të hyrat vetanake ishin 91,001 euro, në vitin 2009 të hyrat kishin rënë në 72,734 euro, ndërsa trendi i rënies vazhdoi në vitin 2010 me 29,996 euro, në vitin 2011 rreth 20,000 euro, dhe në vitin 2012 me 25,457 euro¹⁹.

¹⁹ Raportet e ZAP për MKRS

GRAFIKA 11: Trendi i të hyrave vetanake të institucioneve vartëse të MKRS

Burimi: Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Kriteret për ndarjen e buxhetit

Siç u pa edhe në kapitullin e orientimit strategjik kulturor, Kosova nuk ka strategji të veçantë për kulturë.

Orientimet e saj strategjike për kulturën janë të identifikuar vetëm në dokumentet tjera strategjike, por edhe ato dokumente ndryshojnë prej vitit në vit. Megjithatë, në KASH 2014–2016, për herë të parë u prezantua një listë indikatorësh, në bazë të së cilëve do të matej performanca e MKRS: numri i festivaleve brenda vendit drama-teatër; pjesëmarrja në arenën ndërkombëtare kulturore; realizimi i shfaqjeve në filarmoni, operë, balet; mbështetja e filmave në kinematografi; numri i ekspozitave-galeria e arteve; bashkëpunimet brenda dhe jashtë vendit; përmirësimi i infrastrukturës fizike, numri i projekteve; përkrahja e projekteve për libër/revistave letrare²⁰.

Pothuajse në të gjitha rastet është më mirë të ketë indikatorë të matjes së punës sesa të mos ketë, mirëpo përzgjedhja e indikatorëve është faktori kyç për vlerësimin e një politike. Indikatorët e përzgjedhur nga KASH kanë për qëllim kuantifikimin e aktiviteteve kulturore dhe si rrjedhojë edhe vlerësimin e suksesit apo dështimit

të punës së MKRS-së gjatë një viti, duke pasur për bazë të vetme numrin e ngjarjeve kulturore. Kjo lloj politike fokusohet ekskluzivisht në kuantitetet dhe të anash cilësinë e aktiviteteve kulturore. Për shembull, me anë të indikatorëve të përzgjedhur, një festival si DokuFest, i cili ka rreth 10,000 vizitor dhe kontribuon në GDP-në e vendit deri në 3.8 milion euro në vit²¹, barazohet me një festival të tematikës së njëjtë, por të performansës shumë më të dobët. Rrjedhimisht, misioni i MKRS-së do të duhej të ishte zhvillimi cilësor i kulturës dhe jo vetëm zhvillimi numerik i saj.

Edhe pse është shumë herët që të shohim efektet e këtyre indikatorëve në politikën publike, publikimi i listës së projekteve fituese për kulturë²² për vitin 2014 mund të na japë një pikëpamje. Pas konkursit të shpallur nga MKRS, fitues dolën 266 projekte, 25 nga fusha e teatrit, 21 nga fusha e kinematografisë, 52 nga artet muzikore, 22 nga takimet letrare, 26 nga bibliotekat, 42 nga artet vizuale, 33 nga sektori i promovimit, dhe 45 nga sektori i diversitetit dhe komuniteteve. Përrjashtuar dy projekte të mëdha që kushtuan 22,000 dhe 20,000 euro, shumata më e madhe e

²¹ Impakti Ekonomik i Dokufestit për periudhën 2011–2014, Instituti GAP, 2011, në http://www.institutigap.org/documents/66380_ImpaktiEkonomikDokufest.pdf

²² Për më shumë, shih listën e plotë në http://mkrs-ks.org/repository/docs/Projektet_kulturore.pdf

TABELA 4: Indikatorët e performancës së MKRS sipas KASH 2014-2016

Indikatorët kyç të performancës	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	aktuale	aktuale	plani	plani	plani	plani
Përkrahja dhe diplomacia e kulturës						
Numri i festivaleve brenda vendit drama-teafër	3	4	5	6	6	7
Pjesëmarrja në arenën ndërkombëtarë-kulturore	8	8	9	10	12	13
Realizimi i shfaqjeve të filharmoni, operë, balet	3	3	4	5	5	5
Mbështejta e filmave të kinematografisë	2	2	2	3	2	2
Numri i ekspozitave - galeria e arteve	14	17	22	22	25	25
Bashkëpunimet brenda dhe jashtë vendit	10	10	12	15	20	20
Përmirësimi i infrastrukturës fizike, nr. i proje.	3	4	4	5	5	6
Përkrahja e projekteve për libër/revistave letrare	30	78	82	88	100	100
Ruajtja, mbrojtja e trashëgimisë kulturore						
Hartimi i planeve zhvillimore dhe planeve të menaxhimit	4	4	5	5	6	6
Realizimi i projekteve nga programi / Masa preventive - intervenime emergjente	19	20	21	24	25	25
% e realizimit të projekteve	100%	98%	-	-	-	-
Gërmimet arkeologjike me karakter hulumtimi dhe shpëtimi sipas nevojës	3	4	4	3	5	5
Vizitat e monumenteve historike	10,500	11,500	15,200	16,000	16,600	20,000
Lista e përkohshme e objekteve nën mbrojtje	1,170	1,182	1,182	-	-	-

dhënë për një projekt ishte 15,000 euro, mesatarja 2,900 euro ndërsa më e vogla ishte 500 euro. Vetëm sa për të paraqitur në perspektivë këto shifra, një këshilltar i Ministrit të MKRS kishte shpenzuar rreth 840 euro në vit vetëm për telefoni mobile në vitin 2012, ndërsa po në atë vit, Ministri dhe zëvendësministri e MKRS vetëm për dreka zyrtare kishin shpenzuar 8,000 euro²³. Pra, shihet tendenca që fondet e dedikuara për aktivitetet kulturore të shpërndahen sa më shumë në mënyrë që të arrihen caqet në indikatorët e performancës. Kjo qasje është degraduese ndaj zhvillimit kulturor të vendit.

Për më shumë, aktivitetet kulturore financohen përmes linjës buxhetore të subvencioneve dhe transfereve. Pikë së pari, termat subvencion dhe transfer kanë kuptimin e transferit të mjeteve tek individët, ndërmarrjet, apo organizatat, mjete të cilat si kthim nuk kërkojnë kompensim – siç mund të jenë mallrat dhe shërbimet – dhe si të tillë janë denigrues për sektorin e kulturës. Në përgjithësi, termat subvencion dhe transfer kanë konotacionin e ndihmës shtetërore për sektorët joproduktiv apo që janë në krizë deficitare, për individët në nevojë për asistencë sociale dhe çështjet e

tjera që më shumë kanë të bëjnë me vullnetin e mirë dhe ‘bamirësinë’ e institucioneve për mirëqenien e vendit. Për më saktë, në dokumentet zyrtare të Kosovës subvencionet definohej si “transfere të njanshme, të pakthyeshme në llogari rrjedhëse për industrinë private dhe ndërmarrjet publike. Pagesa e pakthyeshme është e njanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim për pagesën²⁴”, ndërsa transferet si “pagesa të njanshme, jo të kthyeshme për qeveritë tjera, institucionet jopropitabile, familjet dhe individët. Transferet për individët përfshijnë programet e mirëqenies sociale, siç janë pensionet. Transferet për institucionet jopropitabile përfshijnë mbështetjen që iu jepet institucioneve kulturore, sportive dhe joqeveritare, ku nuk kërkohet asgjë specifike si kthim për këto pagesa dhe ku institucioni jopropitabil nuk financohet dhe nuk kontrollohet kryesisht nga qeveria.”²⁵

Pra, meqë nga mjetet e dhëna si subvencione dhe transfere nuk kërkohet asgjë specifike si kthim, edhe procesi i dhënies së këtyre mjeteve nuk shkon në procedura strikte. Transferimi i mjeteve nga linja buxhetore për subvencione dhe

23 Si i shpenzon shteti paratë tona? Raportet mbi Ndarjet dhe Shpenzimin e Parasë Publike në <http://tinyurl.com/ome2ex6>

24 Udhëzimi Administrativ Nr.8/2005. Klasifikimi Ekonomik i Shpenzimeve.

25 Ibid.

transfere nuk shkon përmes procedurës së prokurimit²⁶. Megjithatë, për çdo pagesë të subvencionit dhe transferit duhet të ketë bazë ligjore; bazë ligjore konsiderohet ligji, rregullorja, apo vendimi i institucionit përkatës²⁷. Kjo nënkupton se institucioni i MKRS-së – Ministri si përgjegjës për ministrinë – mund të marrë vendim të pagesës së subvencionit dhe transferit pa ndonjë arsytim të veçantë. E njëjta është e aplikueshme edhe te kryetarët e komunave, në rastin e subvencioneve dhe transfereve nga DKRS, edhe pse disa prej komunave kanë rregullore për ndarjen e subvencioneve ku zakonisht caktohen disa kriterë bazike për ndarjen e subvencioneve²⁸.

Ndonëse në MKRS praktika është që për financimin e projekteve shpallen konkurse dhe pastaj juria e zgjedhur nga zakonisht MKRS ose institucionet kulturore përgjegjëse bën përzgjedhjen e projekteve fituese, praktikë kjo e cila merr mendimet e jurisë të konsistuar nga disa njerëz që zakonisht i takojnë fushës së projektit, i gjithë procesi i financimit

26 Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF – Shpënzimi i Parave Publike

27 Ibid.

28 Disa prej komunave që kanë rregullore për ndarjen e subvencioneve janë Komuna e Gjilanit, Komuna e Podujevës, ndërsa disa tjera komuna, si Komuna e Obiliqit dhe Shtërpçës, janë në procedurë të aprovimit të një rregullore të filltë.

të aktiviteteve kulturore nga buxheti për subvencione dhe transfere mbetet i pa rregulluar. Në gazetën zyrtare dhe në uebsajtin e MKRS nuk figuron ndonjë dokument i cili e rregullon këtë çështje, aq më pak të caktojë kriterë që projektet do të duhej t'i përmbushin. Kjo krijon hapsirë për financim të kulturës në baza të preferencave të stafit të institucionit financues, kryesisht udhëheqësit të këtyre institucioneve, qoftë Ministri i MKRS apo kryetarët e komunave në rastin e DKRS. Si rrjedhojë, krijohet një sistem ku nuk financohen projektet në baza të meritokracisë, por në baza të preferencave të individëve brenda institucioneve financuese, apo në baza të lidhjeve me këta njerëz.

Problematikë tjetër e madhe që e shoqëron procesin e financimit përmes linjës së subvencioneve dhe transfereve është mosmbyllja e avanceve. Financimi i projekteve përmes subvencioneve dhe transfereve shkon përmes dhënies së avanceve. Këto avance do të duhej të shërbenin për nisjen e projektit dhe përfundimin e tij. Në fund të projektit, duhet të raportohet mbi projektin dhe të mbyllet avanci i dhënë. Pra, mbyllja e avancit nënkupton menaxhimin e financave, përformancës dhe përmbylljes së projektit. Megjithatë, përmbyllja e

Konkluzion

avanceve mbetet shumë problematike. Në fund të vitit 2010, mbi 30 për qind e avanceve për atë vit kishin mbetur të hapura²⁹. Është praktike që në fund të vitit, në pamundësi të përmbylljes së avancit në mënyrë të rregullt, avanci ose përfundon i hapur dhe projekti vazhdon të mos raportojë, ose avanci përmbillet pas një procedure krejtësisht formale vetëm për të përmbyllur avancin³⁰.

Kultura vazhdon të mbetet në margjinat e politikave publike në Kosovë.

Përkundër transferimit të kompetencave dhe përfundimit të prioriteteve shtet ndërtuese, që për një periudhë të gjatë kishin thithur energjitë kryesore të elitës Kosovare, vendi i kulturës në prioritetet publike mbetet i njëjtë. Dokumente që caktojnë orientime strategjike për sektorin e kulturës mungojnë. Në mungesë të një strategjie për kulturën dhe dokumenteve tjera strategjike, orientimet strategjike kulturore të Kosovës duhet të shihen në dokumente si Korniza Afatmesme e Shpenzimeve. Në këtë të fundit, kultura përbën një pjesë të vogël dhe të parëndësishme në relacion me prioritetet e tjera. Gjithashtu, bartës të zhvillimit kulturor konsiderohen të jenë institucionet kulturore publike, ani pse aktiviteti më i madh dhe më cilësor kulturor vjen nga institucionet e pavarura kulturore. Për më shumë, investimet në infrastrukturë shihen si mënyra primare e zhvillimit të kulturës, përkundër faktit që për një zhvillim të qëndrueshëm të kulturës nevojitet shumë më shumë investim në kapital njerëzor dhe në rritjen e cilësisë kulturore. Megjithatë, kjo qasje nënçmuese ndaj kulturës në përgjithësi

²⁹ Raporti i ZAP për MKRS 2010

³⁰ Intervistë me zyrtarë të MKRS, me datën 29 Maj 2014.

dhe qasje neglizhuese ndaj sektorit të pavarur kulturor fillon të ndryshojë në dy vitet e fundit. Ndryshimi ka të bëjë me prioritizimin e përkrahjes së aktiviteteve kulturore dhe prioritizimin e institucioneve të pavarura kulturore përkrah institucioneve kulturore publike, së paku në dokumente zyrtare.

Kjo qasje e institucioneve publike ndaj kulturës shihet edhe në alokimin e buxhetit për kulturë. Edhe pse buxheti për MKRS prej vitit 2008 deri në 2014 pothuajse dyfishohet, si përqindje e buxhetit total të nivelit qendror të Republikës së Kosovës buxheti për MKRS rritet prej 1.05 përqind në vitin 2008 në 1.69 për qind. Mirëpo, nga kjo rritje nuk përfiton sektori i kulturës, pasi buxheti i sektorit të kulturës brenda MKRS si përqindje e shpenzimeve totale të nivelit qendror mbetet pothuajse i njëjtë gjatë viteve. Ndërsa nga rritja absolute e numrave të buxhetit, përfitojnë më së shumti investimet kapitale. Kjo reflekton mendësinë e qeverisjes nga viti 2007 që shpenzimet publike të orientohen kryesisht në investime në infrastrukturë. Niveli komunal është gjithashtu në linjë me nivelin qendror. Trendët e nivelit qendror mund të shihen edhe në nivelin komunal. Megjithatë, procesi i krijimit të komunave të reja

në Kosovë ndikon negativisht buxhetin për kulturë, pasi që komunat e vogla kanë tendencë të shpenzojnë më pak për kulturë në relacion me shpenzimet totale. Gjithashtu, komunat e vogla kanë tendencë të shpenzojnë më shumë në paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, dhe shpenzime komunale sesa në subvencione dhe transfere dhe investime kapitale – të cilat ndikojnë direkt në zhvillimin e kulturës.

Edhe ky pak buxhet i ndarë për kulturë ndahet në mënyrë aspak të barabartë ndërmjet entiteteve kulturore. Institucionet publike kulturore diskriminohen pozitivisht në masë të madhe, duke rezultuar që prej 60 për qind deri në 98 për qind të të gjithë subvencioneve të shkojnë për sektorin publik. Ky diskriminim prish ‘tregun’ kulturor në vend, dhe pengon zhvillimin e mëtutjeshëm të kulturës. Për më shumë, institucioneve publike kulturore iu mungon plotësisht insentiva që të krijojnë të ardhura vetanake. Financimi i tyre është i rregulluar me ligj dhe ligji thotë se përgjegjës për financimin e tyre është MKRS dhe komunat përgjegjëse. Andaj institucioneve kulturore publike iu alokohet buxheti që më shumë gjason me grante institucionale sesa me përkrahje për projekte të caktuara. Në

fund, edhe sikur të ekzistonte vullneti për të mbledhur sa më shumë të hyra vetanake nga institucionet publike kulturore, mënyra e rregullimit të tyre bën të ardhurat vetanake të tyre të derdhen në buxhetin e konsoliduar të Kosovës apo në buxhet të komunës, gjë e cila mbyl atë vullnet për mbledhje të sa më shumë të hyrave vetanake.

Në fund, përzgjedhja e indikatorëve të cilët matin numrin e ngjarjeve kulturore në Kosovë për matjen e përformancës së MKRS, politikë kulturore kjo e elaboruar në KASH 2015-2017, ka rezultuar në shpërndarjen e atyre pak mjeteve për subvencione në numër të madh të projekteve. Kjo mbase është e kuptueshme, duke pasur parasysh që MKRS dëshiron të paraqitet e suksesshme para indikatorëve numerikë të saj. Mirëpo të ndjekësh politikë të numrave të ngjarjeve kulturore në vend se fokusi të bjerë te cilësia e atyre ngjarjeve është politikë degraduese për kulturën dhe e shndërron kulturën në lojë numrash. Përpos politikës së gabuar të shpërndarjes së fondeve për kulturë, mungesa e sistemit të kontrollit dhe përformancës në dhënien e subvencioneve paraqet gjithashtu problematikë shumë të madhe.

Megjë kultura financohet përmes subvencioneve, fondet për kulturë bien pre e preferencave të disa individëve brenda institucioneve financuese, qoftë ajo MKRS apo komunat. Subvencionet për shkak të natyrës së tyre nuk kanë nevojë të kalojnë në procesin e prokurimit për shpërndarjen e mjeteve, por kalojnë në procedura më të lehta dhe për shpërndarjen e tyre mjafton një vendim i institucionit. Dokumente të cilat rregullojnë procesin e shpërndarjes së subvencioneve mungojnë dhe caktojnë kritere për shpërndarjen e subvencioneve, në përjashtim të disa komunave të cilat kanë aprovuar rregulloren për shpërndarjen e subvencioneve ku në vija të trasha e rregullojnë këtë çështje. Përpos që mungojnë këto dokumente, procesi i shpërndarjes së subvencioneve gjithashtu has në problemin e mos mbylljes së avanceve, gjë e cila tregon për menaxhimin e dobët të mjeteve dhe të përformancës së projekteve të financuara.

Forumi Kulturor

Teatri Oda organizoi një mori takimesh informative gjatë fundvitit 2011 me qëllim të krijimit të një rrjeti të përbashkët të organizatave të kulturës në Kosovë.

Në këto takime morën pjesë më se 60 pjesëmarrës, përfaqësues nga organizata të ndryshme të kulturore dhe kështu u krijua mundësia e organizimit të Kuvendit themelues, i cili u mbajt me 23. 03. 2012 dhe vuri themelet e Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi Themelues vuri themelet e Forumit Kulturor, duke anëtarësuar 22 organizata të pavarura në kuadër të Rrjetit. Përmes votave demokratike u aprovua statuti, njëkohësisht u zgjodh edhe Kryesia e rrjetit. Forumi Kulturor është etnitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura kulturore si anëtare. Si sekretariat i përkohshëm i Forumit Kulturor është vendosur të jetë Teatri ODA deri në momentin e ngritjes së kapaciteteve për të formuar një Sekretariat profesional të rrjetit.

Forumi Kulturor i Kosovës është Rrjet i Organizatave të Pavarura të Kulturës të Kosovës themeluar me qëllim të:

- Fuqizimit të organizatave të

pavarura kulturore duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për realizimin e programeve të tyre,

- Afirmimit të organizatave anëtare,
- Përfshirjes së organizatave anëtare në proceset vendimmarrëse,
- Rritjes së përkrahjes së skenës së pavarur të kulturës,
- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

Forumi Kulturor synon të përmbushë misionin e vet nëpërmjet aktiviteteve si:

- Komunikimi dhe rrjetëzimi i organizatave të pavarura në fushën e kulturës,
- Shkëmbimi dinamik i informacioneve dhe përvojave,
- Aktiviteteve të lobimit dhe avokimit,
- Trajnimeve specifike për nevojat e organizatave anëtare,
- Organizimi i debateve dhe forumeve,
- Bashkërenditja e aktiviteteve artistike dhe kulturore.

Forumi për Zhvillim Kulturor

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt që ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke ofruar këshilla dhe njohuri të vlefshme për politikat kulturore të Kosovës.

Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë, ndërsa bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe DokuFest. Projekti ka filluar me aktivitetet e para në dhjetor të vitit 2013, ndërsa parashihet të zgjasë deri në nëntor të vitit 2015. Në një periudhë dyvjeçare, Forumi për Zhvillim Kulturor do të prodhojë të paktën 28 produkte të politikave të kulturës, të cilat do të rezultojnë nga hulumtime, debate, fokus grupe dhe konferenca. Projekti do të forcojë rrjetin e komunitetit të kulturës së pavarur, të ndërtojë kapacitetet e saj të brendshme dhe të ndikojë në hartimin e politikave kulturore të Kosovës përmes prodhimit të dijes për kulturë. Po ashtu, projekti do të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mes sektorit të kulturës së pavarur dhe autoriteteve publike në mënyrë që të dalë me zgjidhje konkrete për zhvillimin kulturor në Kosovë.




Projekt i financuar nga BE-ja dhe i
menaxhuar nga Zyra e Bashkimit
European në Kosovë

Implementuar nga:



FORUMI
KULTUROR





forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor

